



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 04

Datë: 08.02. 2023. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

-Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes 02/2023

2. Aktivitetet e SKQZ-së

3. Raportet e Këshillave të KQZ-së

• Këshilli për Operacione Zgjedhore

- Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan,

Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq, që do të mbahen më datë 23 Prill 2023

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq, që do të mbahen më datë 23 Prill 2023

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raporti të shpenzimeve të derivateve për muajin janar – dhjetor 2022

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të kuvendit Komunal në Viti, Gllogovc dhe Fushë Kosovë

- **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për vëzhgimin e zgjedhjeve të përgjithshme në Estoni dhe Finlandë si dhe zgjedhjeve Presidenciale në Mal të Zi

4. Të ndryshme!

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së, pas hapjes së takimit, paraqiti agjendën e takimit para anëtarëve të KQZ-së. Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së miratuan rendin e ditës me 8 vota për dhe asnjë kundër...dhe po ashtu, miratuan edhe procesverbalin e mbledhjes nr. 02/2023 të KQZ-së.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ-së, paraqiti aktivitetet e sekretariatit mes dy mbledhjeve. Ai, tha se aktiviteti nr. 10 i planit të punës së KQZ që përfshin raportin vjetor financiar të KQZ-së për vitin 2022 dhe raporti vjetor i punës së KQZ-së për vitin 2022 për Kuvendin e Republikës së

Kosovës janë në proces të draftimit. Sekretariati ka filluar nga muaji janar 2023 të draftojë raportin, duke mbledhur të dhënat nga raportet e të gjitha departamenteve dhe pritet që drafti dhe shqyrtimi në sekretariat të përfundojë deri në fund të muajit mars 2023.

Në KQZ, do të shqyrtohet gjatë muajit prill dhe koha e fundit për dërgim të raportit në Kuvendin e Republikës së Kosovës është 30 prill 2023. KQZ e ka aprovuar raportin vjetor financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022. Ky raport pastaj, më 27 janar 2023 është dërguar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht në Thesar.

Në planin e punës së KQZ për vitin 2023 është edhe aktiviteti nr. 23 rishikimi i specifikave teknike për materialet zgjedhore (furnizime dhe shërbime). Po ashtu në raportin nga Njësia e Auditimit të brendshëm në SKQZ një ndër pikat që është audituar është furnizimi me distinktiv dhe në bazë të gjeturave rekomandohet rishikimi dhe thjeshtimi i specifikave të furnizimi me distinktiv.

Nga procesi i rishikimit të specifikave teknike, deri me tani janë rishikuar specifikat teknike për furnizime me distinktiv (ID Bexha) dhe procedurat dhe furnizimet planifikohen të zhvillohen për procesin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune në Mitorvicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok dhe zgjedhjeve të parakohshme për kuvendin komunal në Zveçan dhe leposaviq, që do të mbahën më 23 prill 2023.

Për aktivitetin r.r. 30 të Planit të Punës 2023 “Rishikimi i Udhëzimeve Administrative të KQZ-së”, është formuar Komision për rishikimin e Udhëzimeve Administrative dhe ndryshim/plotësimet eventuale. Komisioni punën pritët të fillojë nga data 08 shkurt 2023 dhe do ta përfundojë me datë 30 mars 2023. Më pastaj UA të ndryshuara dhe plotësuara do të dërgohen në KQZ për shqyrtim dhe miratim.

Kryeshefi Ahmetaj, tha se rreth aktivitetit nr. 34 të Planit të Punës 2023 “miratimi i Listës së Qendrave të Votimit pas Analizës dhe Vlerësimit të Qendrave të Votimit” (aktivitet i bartur nga viti 2023) dhe deri me tani janë zhvilluar aktivitete siq janë: a) Përfshirja e propozimeve teknike të ZLKZ-ve, të cilët i kanë dhënë lidhur me listën e qendrave të votimit, që ka qenë pjesë e analizës dhe vlerësimit të qendrave të votimit, b) Hartimi i raportit. Për këtë aktivitet ka mbetur shqyrtimi dhe miratimi i listës së qendrave të votimit e standartizuar e cila periudhen e miratimit e ka në mujt shkurt – mars 2023.

Gjithashtu, lidhur me strategjinë e KQZ-së 2023-2026, për të ndarë përgjegjësitë edhe më shumë, z. Ahmetaj e informoi KQZ-së mbi atë se, janë caktuar bartës apo përgjegjës për secilën shtyllë strategjike të cilët do të punojnë me grupe tjera dhe në fund do ti përmbledhin të gjithë punën e secilës shtyllë. 1. Shtylla Strategjike 1 *Qëndrueshmëria dhe fuqizimi institucional* (z. Kreshnik Spahiu). 2. Shtylla Strategjike 2 Korniza Ligjore (z. Haki Krasniqi). 3. Shtylla Strategjike 3 Gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja në zgjedhje (z. Valmir Elezi). 4. Shtylla Strategjike 4 Inovacioni dhe teknologjia (z. Visar Kastrati). 5. Shtylla Strategjike 5 Bashkëpunimi dhe transparenca (z. Premtim Rrustemi). Bartësit, kanë finalizuar aktivitetet për “shtyllën e tyre”, duke plotësuar me veprimet strategjike, objektivat, personat përgjegjës, aktivitetet strategjike, indikatorët dhe informata tjera dhe në fund para organizimit të punëtorisë.

Në vazhdim, krye shefi Ahmetaj tha se në kuadër të planit të punës së KQZ-së, është aktiviteti nr. 15, ngritja e kapaciteteve të stafit të KQZ-së, që ka për qëllim ngritjen e kapacitetit të stafit. Aktiviteti do të zhvillohet gjatë tërë vitit dhe në fund duhet të përgatitet Raport të trajnimeve të mbajtura. Për këtë vit janë 18.800 euro në buxhet për trajnime dhe ngritje të kapaciteteve.

Në lidhje me këtë, me qëllim të përgatitjes së një plani në bazë të vlerësimit të nevojave për ngritje të kapaciteteve të stafit, Kryeshefi Ekzekutiv ka ndërmarrë veprimet si në vijim: a) Identifikimi i nevojave për trajnim për stafin e KQZ-së; b) Pjesëmarrja në trajnim; Lidhur me këtë, është angazhuar znj. Valbona Kida, Udhëheqëse e Divizionit të Trajnimit, e cila do të ndihmohet nga znj. Vahide Behrami, Udhëheqëse e Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përbashkëta dhe me përkrahje nga z. Bujar Basha (OSBE), të hartojë koncept dokumentin, duke përfshirë edhe afatet kohore për implementimin e identifikimit dhe vlerësimit të nevojave për trajnime.

Po ashtu, Sekretariati në secilin vit, në buxhetin e tij parasheh buxhet për trajnime specifike dhe të cilat nuk kemi arritur pothuajse fare ti shpenzojnë sipas planifikimit, ku edhe kërkesat kanë qenë të paqarta se qfarë trajnimesh do të nevojiten sipas kërkesave buxhetore. Me qëllim të ndërtimit të një sistemi të analizimit dhe vlerësimit të nevojave për ngritjen e kapaciteteve dhe përcjelljen e vazhdueshme të implementimit të këtij aktiviteti, kam kërkuar ndërtimin e një sistemi që do të analizojë kërkesat, vlerësoje dhe përcjell implementimin.

Grupi punues (GP) ka përgatitur koncept dokumentin për vlerësimin dhe analizimin e nevojave për trajnim dhe pyetësorin në të dy gjuhët. Pyetësori në gjuhën shqipe do të bëhet në mënyrë elektornike përmes survey monkeys që përkrahet nga OSBE ndërsa në gjuhën serbe do të

plotësohet në MS Word. Grupi punues ka përgatitur agjendën dhe kalendarin për zhvillimin e aktiviteteve.

Raporti parashihet të përgatitet deri më 02 mars 2023 dhe më pastaj me identifikimin e trajnimeve dhe zyrtarëve të cilët nevojitet të trajnohen. Në Mbledhjen e KQZ 03/2023 të datës 27.01.2023, është miratuar plani i rekrutimit për vitin 2023, ku për pozitat e lira në Sekretariat do të zhvillohen procedurat e rekrutimit në një fazë më të vonshme. Pozita Zyrtar i financave – zotues e cila është e lirë nga shtatori i vitit 2022, aktualisht është duke funksionuar me zyrtarin alternativ përmes marrëveshjes së bashkëpunimit me Këshillin e Pavarur të Mediave.

Zyrtari alternativ i caktuar nga SKQZ, akoma nuk ka mundur të trajnohet dhe Sekretariati kërkesën për trajnim e ka dërguar në Thesar, që nga muaji nëntor 2022. Akoma jemi në pritje të ftesës për trajnim. Për shkak që të mos ngecim në punë dhe pikënisje për pagesat është zyrtari financiar zotues, jemi detyruar të nënshkruajmë marrëveshje me Këshillin e Pavarur të Mediave, duke caktuar zyrtarin për kryerjen e shërbimeve të zotimit të mjeteve, për KQZ.

Koha e cila është caktuar për zhvillimin e procedurave të rekrutimit të kësaj pozite, tha z. Ahmetaj, është nga muaji Maj 2023 dhe procedurat e rekrutimit marrin kohë nga 2-3 muaj. Për shkak të rëndësisë së domosdoshme, rekrutimi në atë fazë, Institucionit tonë, do ti shkaktojë vështirësi në pagesa dhe funksionim. Për shkak të rëndësisë së veçantë dhe nevojës së domosdoshme të rekrutimit për këtë pozitë, rekomandohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që për pozitën Zyrtar i Financave – zotues, procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar i Financave – zotues të fillojë nga data 10 shkurt 2023, tha në fund z. Ahmetaj.

Në diskutimet pas këtij raportimi të aktiviteteve të sekretariatit brenda dy takimeve, Sami Kurteshi, diskutoi rreth planit të rekrutimit, në fakt për dy pozita “zyrtari financiar” dhe e dyta, kërkesa “për një auditor të brendshëm që, edhe është obligim ligjor dhe që e ka kërkuar edhe zyra kombëtare e auditimit...

Ne, konstatoi z. Kurteshi, mund t'i ikim, por ne e kemi obligim ligjor...!

Arianit Elshani, lidhur me raportin tha se e mirëpres si aktivitet “rishikimin e specifikave të materialeve zgjedhore”, sepse sic është konstatuar edhe nga auditori është fjala për një shumë të madhe parash për operatorët ekonomik për shkak të kriterëve rigoroze të KQZ-së për shtypjen e disa benxheve që realisht, duhet të jenë të thjeshtë sepse, realisht edhe nuk ka qenë e nevojshme

që të komplikohen në atë formë si janë bërë...Prandaj, e mirëpres angazhimin e sekretariatit për ti rishikuar të gjitha specifikat e materialeve zgjedhore, sepse disa janë të trashëguara por tash nuk është e nevojshme që disa specifika të jenë strikte, ngase kanë qenë barrë e madhe – kosto e madhe e KQZ-së...

Lidhur me planin e rekrutimit, z. Elshani tha se, mbështetë procesin e rekrutimit, përfshirë edhe propozimin e z. Kurteshi...

3. Këshilli për Cështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të kuvendit Komunal në Viti, Gllogoc dhe Fushë Kosovë:

Sami Hamiti, tha se këshilli është takuar dhe ka shqyrtuar kërkesat në vijim lidhur me zëvendësime të asambleistëve! Konsiderojmë se, çdo gjë është proceduar në pajtim me ligjin. Rekomandojmë të bëhen zëvendësimet në Viti, Gllogoc dhe Fushëkosovë. Kështu, nga kuvendi komunal i Vitisë rekomandojmë që Marigona Avdiu, zëvendëson asamblisten e deritashme nga radhët e LDK –së në kuvend Taibe Ibrahimin.

Këtu, më duhet të bëjë një sqarim: kemi pas komunikime edhe me MAPL-së sepse, znj. Ibrahimini ka munguar më shumë se 10 seanca, prandaj edhe janë plotësua kriteret për zëvendësimin e saj...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim.

Sami Hamiti: Manushaqe Maulaku nga Kuvendi Komunal i Gllogocit subjekti politik PDK, e zëvendëson asambleisten e deritashme Agnesë Kastratin – Bucolli. Janë plotësuar kushtet që të bëhet ky zëvendësim...

Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për e miratuan këtë zëvendësim.

Sami Hamiti: Gjithashtu, nga Kuvendi Komunal i Fushë Kosovës, asambleisten e deritashme Eglantina Azemin – Veseli nga subjekti Politik Lëvizja “Vetëvendosje!”, e zëvendëson Doruntina Jashari, Rekomandojmë që të bëhet ky zëvendësim sepse, janë plotësua të gjitha kushtet procedurale që të bëhet ky zëvendësim...

Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për e miratuan këtë zëvendësim.

4. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për vëzhgimin e zgjedhjeve të përgjithshme në Estoni dhe Finlandë si dhe zgjedhjeve Presidenciale në Mal të Zi:

Kreshnik Radoniqi: I kemi tre vende ku kanë mu mbajt zgjedhje, në Estoni, Finlandë dhe Mal të Zi, është edhe Shqipëria por kjo pak më vonë...

Këto shtete pranojnë vëzhgues, kemi komunikue vetëm se, jo me Malin e Zi sepse duhet të komunikojmë me ministrinë e jashtme...Por, në momentin kur i kemi edhe emrat, komunikojmë dhe na pranojnë...

Ne në këshill, u pajtuam të marrim pjesë...! Në Mal të Zi janë më 19 mars, në Estoni me 5 mars, dhe në Finlande më 2 prill...

Jemi pajtuar që, të shkojmë me delegacion me 3 anëtarë, megjithëse unë isha me 4 veta...Jemi pajtuar me 3, kështu 2 nga KQZ dhe 1 nga Sekretariati...

Kryetari Radoniqi, pastaj shpjegoi prioritetet dhe, faktin se në këshill ka pasur dakordim që të vëzhgohen këto zgjedhje...

Gordana Llaban, kërkoi që të mos jetë pjesë në asnjë nga këto vizita sepse, tha se ka obligime personale dhe se, nuk mund të marrë pjesë... Në anën tjetër, tha që ndoshta më mirë është të ketë ekipi nga 4 anëtarë, sepse ka nevojë edhe sekretariati...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Arianit Elshani, i cili tha se vëzhgimet janë me interes sepse, merren mësim, përvoja dhe çështje të tjera teknike sepse, “këto përvoja” janë duke shërbyer pozitivisht në aktivitetet dhe proceset në KQZ.

Ilir Gashi, tha se, unë nuk do të marrë pjesë në këto vëzhgime, sidomos në Finlandë dhe Estoni, ndoshta po në Mal të Zi...

Sami Hamiti, tha se, nuk do të duhej të kishim “pako” por ndërlidhje, interes dhe nevojë sepse, “3” dhe “4” është formati që mos me kalue në “5” sepse, është tepër...! Unë, në njërin prej këtyre vendeve, do të shkoja...

Arianit Elshani: Unë po vetë propozohem për Estoni, dhe propozoi edhe Fazli Stollajn...dhe, Sami Hamitin...

Kreshnik Radoniqi, tha se Kreshniku, do të duhej të shkonte në Estoni...por, unë mendova se edhe Besnik Buzhala do duhej, sepse edhe zyra do ta ketë “Sofuerin” e tij...

Për Finlandë kush...?

Arianit Elshani: Propozoj Ibrahim Selmanajn...

Kreshnik Radoniqi: Ok, edhe unë...por, edhe një prej zyrës...!

Ilir Gashi: Pse zyra...?

Kreshnik Radoniqi: Pse me u nda...?

Sami Hamiti: Ne, shkojmë si delegacion shtetërorë, format shtetërorë...

Sami Kurteshi: Unë, nuk jam askund mos me udhëtue... Mirëpo, sa i përkite formatit, unë jam vazhdimisht me shkue 2 nga KQZ dhe 1 nga Sekretariati...Kjo, është ideja ime...! Për vete,

Në fund, anëtarët e KQZ-së, vendosën që në Estoni të udhëtojnë: 1.Arianit Elshani. 2. Fazli Stollaj. 3. Kreshnik Spahiu. 4. Besnik Buzhala.

Me 9 vota për, u miratua.

Kurse, në Finlandë do të udhëtojnë: 1. Ibrahim Selmanaj. 2. Sami Hamiti. 3. Burim Ahmetaj.

Me 9 vota për, u miratua.

Mali i Zi: 1. Ilir Gashi. 2. Ibrahim Selmanaj. 3. Sami Hamiti. 4. Fazli Stollaj. Plus – 2 nga Sekretariati, dhe anëtari i ri i VV-së...

Me 9 vota për, u miratua.

5. **Të ndryshme !**